

VENDIM
Nr. 704, datë 6.12.2023

**PËR FINANCIMIN E VEPRIMTARISË SË FONDACIONIT “DURRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY” PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 2, dhe 19, pika 4, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në buxhetin e vitit 2023, në programin buxhetor 08140 “Për zhvillimin e sportit”, në llogarinë ekonomike 604 “Transferta të brendshme”, të përdoret për financimin e shpenzimeve të ushtrimit të veprimtarisë së fondacionit “*Durrab City Football Academy*”.

2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e fondacionit, në bankën e nivelit të dytë.

3. Fondacioni “*Durrab City Football Academy*”, brenda muajit shkurt 2024, të dërgojë zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raportin e shpenzimeve të realizuara për vitin 2023, të miratuara nga Bordi Drejtues i fondacionit.

4. Fondet buxhetore, që do t’i akordohen fondacionit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duhet t’i nënshtrohen rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku